



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja
Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development



Shërbimi Këshillimor Bujqësor Rural i Kosovës
Kosovo Agriculture and Rural Development Advisory Services
Poljoprivredna Ruralna Savetodavna Služba Kosova

Mbjelljet Pranverore- Rëndësia e Kultivimit të Misrit



Të nderuar fermerë,

Jemi në periudhën e mbjelljeve pranverore për kultura të ndryshme bujqësore, ndër to edhe **misri**, një ndër kulturat më të rëndësishme ekonomike dhe strategjike për vendin tonë. Kultivimi i kësaj kulture kërkon kujdes dhe planifikim të veçantë.

Qëllimi kryesor në prodhimtarinë intensive të misrit është rritja e rendimentit për njësi sipërfaqeje, duke ruajtur cilësinë e prodhimit. Duke marrë parasysh rëndësinë e kësaj kulture, **Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR)**, edhe këtë vit ka planifikuar përkrahje financiare përmes subvencioneve për të gjithë fermerët prodhues të misrit.

Misri, me vlerat e tij të larta ushqyese, ka ndikim të drejtpërdrejtë në zhvillimin e sektorit të blegtorisë dhe industrisë ushqimore.

Masat agroteknike për mbjellje

Për të siguruar rendimente të larta dhe prodhim cilësor, rekomandohet zbatimi i masave të duhura agroteknike:

1. **Përgatitja e tokës:** Duhet të bëhet lërimi i thellë, shpërndarja e plehut organik (preferohet në vjeshtë) dhe plehërimi bazë para mbjelljes.
2. **Përdorimi i plehut organik:** Aplikohet në sasi prej rreth **30 ton/ha në vjeshtë**, i cili rrit ndjeshëm vlerën ushqyese të tokës.
3. **Plehrimi kimik:** Në pranverë, rekomandohet përdorimi i **plehut NPK** në raport 2/3 para lërimit të cekët dhe 1/3 gjatë mbjelljes. Sasia orientuese është **500 kg/ha NPK**.
4. **Ripëlhërimi gjatë vegjetacionit:** Në fazën e 5-6 gjetheve, jepen rreth **200 kg/ha Azot (NAG 27%)**, dhe sipas nevojës mund të bëhet edhe një ripëlhërim i dytë me **150 kg/ha**.

Zgjedhja e farës dhe hibrideve

Zgjedhja e farës është element kyç për suksesin në kultivimin e misrit. Duhet të zgjidhen **hibride që janë të përshtatshme për kushtet agroklimatike dhe tokësore**, si dhe të kenë kohëzgjatje të përshtatshme të vegjetacionit:

- Në **Rrafshin e Kosovës:** Hibride të hershme dhe të mesme (**85–120 ditë**).
- Në **Rrafshin e Dukagjinit:** Hibride të vonshme (**121–140 ditë**).

Kujdes: Për kultivim më të suksesshëm dhe me rendimente të larta, **rekomandohet toka të jetë nën sistem ujitjeje**, veçanërisht në zonat më të thata.



Afati optimal i mbjelljes

Afati më i përshtatshëm për mbjelljen e misrit është **prej 15 deri më 25 Prill**, kur **temperatura e tokës arrin 10–12°C**. Mbjellja brenda këtij afati siguron mbirje të mirë, rritje të shëndetshme të bimës dhe rendiment më të lartë në fund të sezonit.

Ku të kërkonit përkrahje dhe këshilla?

Departamenti i Shërbimeve Këshillimore dhe Teknike i MBPZHR-së ju inkurajon të ndiqni **praktikat profesionale bujqësore** dhe të kërkonit **këshilla në Qendrat Informative Këshillimore Komunale për Bujqësi dhe Zhvillim Rural**.

Aty mund të merrni ndihmë lidhur me:

- Zgjedhjen e farës dhe hibrideve
- Përzgjedhjen e plehrave dhe inputeve të tjera
- Menaxhimin e mbjelljes, ujitjes dhe mbrojtjes së bimëve

Kontakti për informata shtesë:

Departamenti i Shërbimeve Këshillimore dhe Teknike – MBPZHR

Rr. “Ukshin Hoti”, Ndërtesa e ish "Ramiz Sadikut", nr. 120, Kati III

Prishtinë, Kosovë

Tel: +383 (0)38 200 38 426